

Raport i Audituesit te pavarur

mbi auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga Partia Alenca Demokratike per fushaten zgjedhore 28.06. 2009.

KOMISJONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE!

Te nderuar zoterinj

Une kam audituar pasqyrat financiare mbi fondet e perfituara dhe te shpenzuara nga Partia Alenca Demokratike per fushaten zgjedhore te 28.06.2009. sipas pasqyres bashkangjitur te ardhura dhe shpenzime per kete periudhe .

Drejtimi eshte pergjegjes per pergaditjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me ligjin nr.10019 dt.29.12.2008 ."Kodi Zgjedhor i republikes se Shqiperise" dhe Ligjit nr.9228 dt29.04.2004,"Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

Pergjegjesia jone si auditues eshte qe te shprehim nje opinion mbi kete pasqyre financiare bazuar ne auditimin tone .

Ne e kryem auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit.Keto standarte kerkojne qe ne te planifikojme dhe te kryejme auditimin tone per te pasur nje siguri te arsyeshme se kjo pasqyre nuk permban anomali materiale .Auditimi perfshin shqyrtimin mbi bazen e testeve ,te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare .

Auditimi perfshin kryerjen e procedurave per te mare evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare .Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit duke perfshire vleresimin e rreziqeve per anomali materiale ne pasqyrat financiare,qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit . paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare ne menyre qe te hartojte procedurat e auditimit qe jane te pershtateshme per rrethanet.

Auditimi perfshin gjithashtu vleresimin e pershtateshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe vleresimet e rendesishme e cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi si dhe per vleresimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyres.

Une besoj se evidenca e auditimit qe une kam mare perben nje baze te arsyeshme per te shprehur opinionin:

Per mendimin tim,pasqyra e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per fushaten zgjedhore 28.06.2009 nga Alenca Demokratike paraqitet ne menyre te sinqerte, ne te gjitha aspektet materiale .

Ekspert Kontabel i Regjistruar

Lulash PJETERNIKAJ

Tirane 31.10.2009

Shenime mbi Pasqyren financiare per fondet e perfituara dhe te shpenzuara nga Partia Alenca Demokratike per fushaten e zgjedhjevet Parlamentare te 28.06.2009.

Partia Aleanca Demokratike eshte futur ne zgjedhjet e 28.06.2009 , dhe sipas te dhenave te mara nga financa e Partise dhe te konfirmuara nga drejtimi i saj , per fushaten zgjedhore ka perfituar fondet e dhena nga buxheti i shtetit dhe ndonje shpenzim te kandidatave te cilet nuk jane te dokumentuara dhe te perfilleshme meqenese donacione te tjera nuk kishte.

Sipas deklarimeve te drejtimit Partia Alenca Demokratike nuk ka pasur asnje dhurim dhe sponsorizim per fushaten zgjedhore as nga persona juridik dhe as nga individ.

Fondi i perfituar nga buxheti i shtetit per kete fushate ka qene ne vleren 2.642.701 leke fondi i fushates zgjedhore eshte transferuar ne llogarine e partis me numer llogarie 0110-301621-100CB me transferim fondi nga thesari me daten 22.06.2009 dhe eshte terheqe nga llogari bankare dhe kaluar ne arke po me daten 22.06.2009.

Llogari tjeter nuk na eshte deklaruar.

Fondi i perfituar nga buxheti eshte administruar nga drejtimi , eshte detajuar dhe perdorur sipas urdherit te Titullarit Ekzekutiv te Partise. Sipas urdherit date 22.06.2009.

Totali i shpenzimeve faktike te perdorura perputhet me planifikimin e bere nga drejtimi i Partise.

Shpenzimet e kryera jane te dokumentuara dhe ne pergjithesi kane fatura te regullta tatimore, Fondet e dhena Qarqeve ne Vleren 360.000 leke ishin dhene me mandate pagesa ndersa per fatura mund te kene mare drejtuesit e Qaqeve ndersa ne Qender ato akoma nuk disponoheshin.

Sipas dokumentacionit te finances nuk kishte fonde te tjera te shpenzuara gjate fushates ,per shpenzime te tjera te kryera nga Kandidatet nuk kishte te dhena te tjera .

Fondet e tjera te cilat jepte buxheti mujore ishin perdor dhe perdoreshin per shpenzime te zakonshme si paga ,sigurime e tj. Te cilat do te paraqiten ne bilancin vjetor kontabel dhe pasqyrene e te ardhura e shpenzime te vitit 2009.

Sa me siper per menyren e pasqyrimet te dhenave per perfitimet dhe shpenzimet e fondeve te fushates nuk kam ndonje vrejte me perjashtim te mungeses se faturave per shpenzimet e dhena Qarqeve qe akoma nuk ishin terheqe faturat e shpenzimeve te cilat duhet te ishin ne sektorin e finances.

**Lulash PJETERNIKAJ lic.109,dt 21.12.2000.
Rruga "Sulejman Pasha" Nr.88.**

PARTIA ALENCA DEMOKRATIKE

Pasqyra e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per fushaten elektorale 28.06.2009.

Nr.	Emertimi i shpenzimit	Arketime ne leke	Pagesa ne leke	Gjendje
1	Fondi i Fushates te 28.06.2009	2.642.701		
2	Shpenzime per postera e fletepalosje.		1.455.500	
3	Shpenzime Telefonike (Vodafo dhe fix)		459.000	
4	Shpenzime per blerje karta telefoni.		55.000	
5	Shpenzime operative per qarqet		360.000	
6	Shpenzime kancelarie.		88.000	
7	Shenzim per blerje kompiuteri e fotokpje		36.201	
8	Shpenzim per ngjitje posterash.		29.000	
9	Shpenzime per blerje karburanti.		110.000	
10	Shpenzime per spote televiziv.(tv .Koha)		50.000	
		2.642.701	2.642.701	